



02/Nr. 4089 /2018  
Data: 10.05. 2018

## PROCESVERBAL I KKSBB-së

Nga mbledhja e katërt- IV- për vitin 2018 mbajtur me datë: 27.04.2018 me fillim pune në ora 14:00, prezent ishin: **Nuhi Dema** (përfaqësues i stacionit policor), **Vahid Hyseni** (përfaqësues i policisë kufitare –vija e gjelbërt), **Menduh Vlasi** (përfaqësues i drejtorisë për arsim, kulturë, rini dhe sport), **Refet Kalisi** (përfaqësues i drejtorisë për shërbime publike dhe emergjencë), **Amir Bushi** (përfaqësues nga zyra për barazi gjinore), **Isa Shkreta** (përfaqësues i E.V.S.B).

Takimin e kryesoj kryetari i komunës z. **Rufki Suma**.

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë mbi sigurinë në komunën e Hanit të Elezit.
3. Të ndryshme.

**Rufki Suma** pasi përshëndeti të pranishmit lexoi rendin e punës dhe pasi që nga të pranishmit nuk pati vërejtje në rendin e punës, njëzëri u miratua rendi i punës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Rufki Suma** a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit,

**Nuhi Dema** vërejtje kam te data e mbajtjes së takimit të mbledhjes së fundit duhet të përmirësohet.

**Rufki Suma** a keni edhe ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

2. Informatë mbi sigurinë në komunën e Hanit të Elezit.

**Rufki Suma** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nuhi Dema** gjatë këtij muaji kemi pas 13 (trembëdhjetë) raste të raportuara. Situata e sigurisë ishte e qetë gjatë këtij muaji.

**Vahid Hyseni** gjatë këtij muaji kemi iniciuar 7 (shtatë) raste. Situata e sigurisë ishte e qetë gjatë këtij muaji.

**Rufki Suma** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka si vlerësim i përgjithshëm është se gjendja e sigurisë në komunën e Hanit të Elezit është e mirë.

### 3. Të ndryshme.

**Rufki Suma** vërejtje i kemi dhënë kompanisë “Bektelenka” për kryerjen e punimeve por po kemi probleme. Problem ka pas te rruga e lagjes së Thaçve por me insistimin tim në Ministrinë përkatëse si kryetarë i komunës dhe nga bllokada të cilën e kanë bërë banorët janë dakorduar që mos me mbyllë rrugën. Banorët e lagjes së Thaçve në Paldenicë kanë paraqitur ankesë edhe për punimet që po zhvillohen sepse po ka rrëshqitje të dheut dhe të gurëve të cilët paraqesin rrezik për banorët në shtëpitë e tyre. Ankesë ka pas edhe nga familja Krasniqi për shkak të punimeve se nuk kanë vendosë mbrojtëse dhe gurët e dheu po bien në oborrin e shtëpisë së tyre. Në kësi situata edhe komuna edhe policia duhet t’i mbron qytetarët. Kompania “Bektelenka” duhet t’i kompenzonë edhe kulturat bujqësore të cilat janë dëmtuar nga pluhuri. Dje ishte në vizitë të pa paralajmëruar presidenti i Shqipërisë z.Illir Meta i cili ishte në Shkodër dhe prej Shkodrës ka pas takim në Maqedoni dhe e ka shfrytëzuar vetëm rrugën transit, mirëpo ndër kohë ambasadori për shkak raporteve të mira që i kemi më ka telefonuar që a mundeni me prituri presidentin. Pas bisedës që zhvilluam potencova që ju presim dhe kontaktova me policinë dhe ata nuk ishin të njoftuar por u organizuan shumë shpejtë në mbajtje të rendit.

**Menduh Vlashi** në mbledhje të komitetit për komunitete është dhënë vërejtje për oborrin e shkollës fillore “Ilaz Thaçi” që duhet të ndriçohet dhe kërkohet edhe nga policia që të ketë patrullime edhe më të shpeshta në mbrëmje sepse ka informacione që grumbullohen të rinjtë.

**Isa Shkreta** është problem çështja e kamionëve të cilët vozisin me shpejtësi të madhe nëpër qytet. Problemi po kanë banorët e fshatrave për kyçje në rrugën kryesore për shkak të kolonës që po bëhet te kufiri. Duhet të shënohet një shenjë me emrin Terminali Doganorë sepse shpesh shoferët po e gabojnë rrugën dhe po vijnë deri te ura e Seqishtë dhe po ka problem me u kthyer prapë.

**Nuhi Dema** sa i përket shpejtësisë së kamionëve e kam angazhuar patrullën, mirëpo vozitësit po ju blindojnë me drita dhe e ulin shpejtësinë sepse e dinë që afër diku është patrulla e policisë. Kolona e kamionëve të kufiri shkaktohet nga një herë për shkak të rënies së sistemit të rrjetit.

Mbledhja përfundoi në ora 14: 35 ju faleminderit për pjesëmarrje.

Procesmbajtësi  
**Ayni Bushi**

